REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 145/17, 150/17
Datë/Datum. 28.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 145/17
150/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE Konzerciumi "N. P. T Mali Art" dhe "Avduli sh. p. k – Kaçanik-Prishtinë si dhe OE "Linda"Sh. p. k- Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pran lumit Nerodime-Projekt tre vjeçar", me nr të prokurimit 656/16/245/521, iniciuar nga AK-/Komuna Viti/ me datën 12.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen** pjesërisht të bazuara ankesat OE Konzerciumi "N.P.T Mali Art" dhe Avduli" sh. p. k – Kaçanik-Prishtinë, si dhe OE "Linda"Sh. p. k- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pran lumit Nerodime-Projket tre vjeçar", me nr të prokurimit "656/16/245/521". I iniciuar nga autoriteti kontraktues KK-/Komuna Ferizaj

II. **Anulohet ,** njoftimi për dhënie i autoritetit kontraktues, KK-/Komuna Ferizaj/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pran lumit Nerodime-Projket tre vjeçar", me nr të prokurimit 656/16/245/521, dhe lënda të kthehet Rivlerësim

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik ankues N.P.T "Mali Art& Avduli" sh. p. k – Kaçanik-Prishtinë si dhe OE "Linda"Sh. p. k- Ferizaj, janë pjesërisht të bazuara, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:05.10.2016. Hapja e ofertave është bërë me dt:25.10.2016, ku kanë marr pjesë tetë operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:11.05.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Konzorciumi"Pro&Co Group dhe "Kema Company-Lipjan.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "N.P.T "Mali Art" dhe Avduli" sh. p. k – Kaqanik-Prishtinë, është bërë me dt:10.05.2017

Si dhe kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Linda"Sh. p. k- Ferizaj, është bërë me dt :11.05.2017

Me dt: 12.05.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "N.P.T "Mali Art" dhe Avduli" sh. p. k – Kaqanik-Prishtinë,

Me dt: 17.05.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "Linda"Sh. p. k- Ferizaj,

Operatori ekonomik OE Konzerciumi "N.P.T "Mali Art" dhe Avduli" sh. p. k – Kaçanik-Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 18 maj 2017 me nr. 145/17, kundër njoftimit për dhënie te kontratës, të AK-së me titull: "Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pran lumit Nerodime-Projket tre vjeçar", me nr të prokurimit "656/16/245/521",duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

Neni 1, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së (Qëllimi).
Neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim dhe/jo diskriminim)
Neni 57 i LPP-së (Sigurimi i tenderit)
Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
Neni 60 i LPP-së (Kriteret e dhënies së kontratës)
Neni 65 i LPP-së (Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderueseve)
Neni 66 i LPP-së (Përshtatshmëria profesionale)
Neni 72 i LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)

Operatori ekonomik "Linda"Sh. p. k- Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 22 maj 2017 me nr. 150/17, kundër njoftimit për dhënie te kontratës, të AK-së me titull: "Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pran lumit Nerodime-Projket tre vjeçar" me nr prok: "656/16/245/521" duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

Neni 1, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së (Qëllimi).
Neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim dhe/jo diskriminim)
Neni 57 i LPP-së (Sigurimi i tenderit)
Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
Neni 60 i LPP-së (Kriteret e dhënies së kontratës)
Neni 61 i LPP-së (Tenderi jo normalisht i ulet)
Neni 65 i LPP-së (Pranueshmeria e kandidatëve ose tenderueseve)
Neni 108 A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjes)

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 07.06 2017, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues që aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pranë lumit Nerodime - projekt tre vjeçar", me nr. të Prokurimit: "656 16 245 521", të iniciuar nga AK – Komuna Ferizaj ta kthej në RI VLERESIM, ndërsa ankesat e OE N.P.T. "Mali Art" &"Avduli "sh .p. - Kaçanik, dhe OE, "Linda" sh. p. k - Ferizaj, të aprovohen pjesërisht si të bazuara

Autoriteti kontraktues me datë 08 qershor 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues N.P. T "Mali Art" dhe Avduli" sh. p. k – Kaçanik-Prishtinë me datë 09 qershor 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Linda"Sh. p. k- Ferizaj me datë 08 qershor 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.06.2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesit i OE ankues, ekspertët e OSHP-së, vëzhguesit nga D Plus- Isuf Zejna ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues Konzerciumi: N.P.T "Mali Art" dhe Avduli" z. Gashi ka deklaruar: Problemet e sotme janë diskutuar dy here më herët ku edhe eksperti i ka elaboruar. Un kam qenë në zyre ligjore në KRPP dh me shkrim kemi marr përgjigje, ku për një vendim që është quajtur i drejt, në seancë të dytë është quajtur i padrejtë. Është diskutuar çertifikata e biznesit, deklarata e konzorciumit, dhe sigurimi i tenderit. Në vlerësimin e ekspertit për tri herë janë elaboruar dhe janë vlerësuar se i plotësojnë kushtet sipas kërkesës së dosjes. Në vendimin panelit të parë edhe çertfikata dhe deklarata janë cilësuar të pranueshme, ndërsa në vendimin e dytë janë vlerësuar të pa pranueshme. Ky është vendim në kundërshtim me vetveten, për një gjë që sot është thënë se është e bardhe i njëjti panel ka thënë është i zi. Sipas LPP deklarata konzoricumit thuhet se nuk i plotëson kushtet dhe, AK ka pas drejt të kërkoj të plotësohet dhe të bëjë të vlefshme.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues:"Linda" z. Berisha ka deklaruar: Nuk kam diçka të veçantë të shtoj përveç atyre që janë në ankesë të datës 07.06.2017. Siç janë cek në ankesë katër pika ankimore. Sa i përket mospajtimit të plotë me ekspertizën e ekspertit, pajtohemi vetëm me pjesën për rivlerësim, ndërsa arsyetimi i OE Mali i Art nuk besoj se është i drejt. Vetëm edhe një sqarim sa i përket OE-ve sipas radhitjes në hapje. Sa i përket OE :"Mali i Art" është i papërgjegjshëm sipas vendimit të OSHP-së të datës 13.04.2017. OE i dytë Pro Cro Group & Kema Company është i papërgjegjshëm sipas pretendimeve ankimore tona. OE i tretë është Rahovica i cili është tërhequr nga gara, nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të dosjes. Dhe në radhë jemi ne si OE më i lirë dhe i përgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KK Ferizaj z. Ibrahimi deklaroj: Herën e parë kemi shpall OE Linda fitues, dhe ka pas ankesë nga Mali art dhe janë aprovuar ankesat. Ne kemi bërë komision të ri dhe kemi rivlerësuar ofertat dhe fitues është shpall Mali art dhe prap ka pas ankesë dh prapë janë aprovuar ankesat. Kjo është hera e tretë dhe nuk dimë çka të bëjmë më shumë pasi kemi respektuar dy vendimet e OSHP-së.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: Pretendimet e OE-ve ankues janë për arsye të eliminimit pas rivlerësimit. Arsyet e eliminimit kundrejt dy OE-ve i kemi vlerësuar dhe të njëjtat arsyetime nuk kanë të dhëna konkrete që vërtetojnë përgjegjshmërinë apo papërgjegjshmërinë e OE-ve. Si arsyetim i eliminimit për OE:"Mali i artë" në letër AK ka potencuar se sipas vendimit të

OSHP-së nr. 68/17, të datës 13.04.2017 jeni të papërgjegjshëm Ndërsa kundrejt OE Linda AK ka potencuar se i njëjti formularin e tenderit pjesën C dhe deklaratën nën betim e ka në kundërshtim me nenin 65 pika. 3.1 të LPP-së. Unë përmes raportit kam propozuar që sipas nenit 72 të LPP të rishikohen ofertat dhe të rivlerësohen dhe të arsyetohet me dëshmi dokumentare në raport me LPP përgjegjshmëria apo papërgjegjshmëria e OE-ve. Shembull formulari C dhe deklarata nën betim e OE Linda sh. p. k, i përmban të dhënat siç parashihet me LPP, mirëpo arsyetimi i eliminimit flet për diçka tjetër, për përgjegjësi të atyre që kanë plotësuar ofertën dhe se e njëjta nuk është argumentuar. Po ashtu ndaj Mali i Artë, nuk është arsyetuar konkretisht se çka konkretisht është i njëjti i papërgjegjshëm por i referohet vendimit të OSHP, ndërsa i njëjti vendim në arsyetim potencon se nuk plotësohet mirëpo përmes rregullave dhe LPP janë disa nga shkresat që mund të plotësohen apo sqarohen , andaj edh kam rekomanduar që dy OE-ve ankesat t'ju aprovohen pjesërisht të bazuara dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Anëtari i panelit z. Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK se a keni përdor nenin 72 në rivlerësim të ofertave. Në përgjigje z. Ibrahimi deklaroj: Po kemi përdore nenin 72 të LPP për gjithë OE-të.

Në fjalë përfundimtare z. Gashi deklaroj: Qëndrojmë pranë pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit të aprovoj ankesën t ë bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare z. Berisha deklaroj: Është e vërtetë se insajderi ka bërë pyetje pranë AK me kërkesë të OE. Ne kemi mbi 60 kontrata me këtë AK dhe çdo herë ka qenë i njoftuar qëndrojmë pranë ankesës dhe i propozojmë panelit të aprovoj të njëjtë të bazuar dhe të shpërblehemi me kontratë pasi që jemi OE më i lirë i përgjegjshëm.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z. Ibrahimi deklaroj: Insajderi ka bërë vet pyetje pranë AK dhe nuk është ftuar nga askush prej AK-së.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues deklaroj: "Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës. 07.06.2017

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se konsorciumi ankues "N.P.T "Mali Art&Avduli sh. p. k" sipas vendimit të OSHP-së 68/17 të datës 13.04.2017 është deklaruar i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën e nenit 11.1 të FDT-së piken b), pasi që nuk ka ofruar një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarë duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marr pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit.

Paneli shqyrtues poashtu konstaton se "N.P.T "Mali Art&Avduli sh. p. k" është shpallur i papërgjegjshëm me vendimin e lartpërmendur të OSHP-së, pasi që nuk e ka plotësuar si duhet edhe formularin për dorëzimin e tenderit pjesën C, për faktin se nuk figuron në këtë pjesë nënshkrimi i personit të autorizuar por janë të shënuar vetëm të dhënat e operatorëve ekonomik në konsorcium. Gjithashtu është konstatuar se ky konsorcium nuk e ka ofruar edhe deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit siç

parashihet në nenin 11.1 pika C e FDT-së por e ka ofruar një autorizim të paqartë dhe në kundërshtim me kërkesën e FDT-së dhe në kundërshtim edhe me nenin71 të LPP-së.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues"N.P.T "Mali Art&Avduli sh. p. k" në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi, pasi që është i papërgjegjshëm.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues "Linda Shpk" edhe eksperti shqyrtues e ka cekur në raportin e tij të dt:07.06.2017 se formulari i tenderit pjesa C dhe deklarata nën betim i përmbajnë të dhënat siç kërkohet me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe konform nenit 72 të LPP-së, të kërkohen sqarime shtesë për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë në lidhje me veprimtarinë e biznesit, pasi që ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit veprimtaria adekuate.

Andaj, Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Blerim DINA

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PRISHTINË/A BELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK "Komuna Ferizaj"

1x1 OE Konsorciumi: "N.P.T "Mali Art&Avduli" sh. p. k – Kaçanik-Prishtinë

1x1 OE "Linda"Sh. p. k- Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.